



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Njoftim për media

Ditën e mërkurë, më datë 04.02.2015, u zhvillua mbledhja e radhës e Këshillit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në prani të anëtarëve të mëposhtëm:

Z. Gentian Sala Kryetar

Z. Gledis Gjipali Anëtar

Z. Piro Misha Anëtar

Z. Zylyftar Bregu Anëtar

Pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës u miratuan vendimet si më poshtë:

1. “Për miratimin e Raportit të Autoritetit të Mediave Audiovizive për vëmprimtarinë e zhvilluar gjatë vitit 2014”;
2. “Për miratimin e Aktit të Brendshëm “Mbi procedurat e rinovimit të licencave të operatorëve privatë audio dhe audiovizivë, të licencuar sipas ligjit nr.8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”
3. “Për miratimin e standarteve teknike të dekoderave për transmetime numerike tokësore”.
4. “Mbi ndryshimet në të dhënat e paraqitura në kërkesën për marrje autorizimi nga subjekti person fizik Riza Jaho, autorizuar për ripërsëritjen e programeve audiovizive të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Toshkëz”.
5. “Mbi ndryshimet në të dhënat e paraqitura në kërkesën për marrje autorizimi nga subjekti person fizik Nevrus Mersuli, autorizuar për ripërsëritjen e programeve audiovizive të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TVM Devolli”.
6. “Mbi ndryshimet në të dhënat e paraqitura në kërkesën për marrje autorizimi nga subjekti person fizik Ervis Beqiri, autorizuar për ripërsëritjen e programeve audiovizive të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV Next Kabëll”.

Këshilli ra dakort të rishikojë ndryshimin e të dhënave të paraqitura në kërkesën për marrje autorizim nga subjektet persona fizikë Gentian Biqiku dhe Dritan Hida, pasi të ketë shlyer detyrimet financiare brenda datës 27.02.2015.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Gjithashtu u morën në shqyrtim aplikimet e paraqitura nga subjektet kabllore për marrje autorizimi për ripërsëritjen e programeve audiovizivë të të tretëve mbështetur në një rrjet kabllor dhe në përfundim Këshilli vendosi për Mosdhënien e Autorizimit për:

1. Tv kabllor Valentino
2. Tv kabllor Drini
3. Tv Kabllor Sean
4. Tv kabllor “Net. 1”
5. Tv Kabllor Manza
6. Tv Kabllor Tele – Net
7. Tv Kabllor Laçi

Këshilli vendosi që të rimarrë në shqyrtim aplikimet e paraqitura nga Tv Eden 3 dhe Zjarr Tv në një kohë të dytë, për shkak të mungesës të kourumit të nevojshëm për vendimmarrje.

Përveç sa më sipër, u morën në shqyrtim ankimet administrative të subjekteve audio dhe/audiovizivë të ndëshkuara me sanksione gjobë dhe në përfundim u vendos:

1. Shfuqizimi i gjobës së vendosur ndaj subjektit kabllor “TV Iliria”;
2. Shfuqizimi i gjobës së vendosur ndaj subjektit kabllor “TV Përrenjas”.
3. Shfuqizimi i gjobës së vendosur ndaj subjektit kabllor “TV Dire”.
4. Shfuqizimi i gjobës së vendosur ndaj subjektit kabllor “TV Devi E.R.I”.
5. Shfuqizimi i gjobës së vendosur ndaj subjektit kabllor “TV Mati”.
6. Shfuqizimi i gjobës së vendosur ndaj subjektit kabllor “Cable Albania Elbasan South”

Këshilli ra dakord të rishikojë vendosjen e sanksioneve me gjobë për subjektet kabllorë:

“TV M&G”, “TV Xhaçi”, “TV Danja”, “TV Maqellara”, “TV HB-CA” dhe “TV Lissus”, pasi të kenë shlyer detyrimet financiare brenda datës 27.02.2015.

Tiranë, më 4 Shkurt 2015